



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## MINISTRIA E DREJTËSISË

### “PARTNERITETI PER QEVERINE E HAPUR” 2020 – 2022”

#### Komponenti nr 3. “Aksesi në drejtësi”

#### Minutat e takimit

**21 Tetor 2020**

---

#### Hyrje

Takimi i katërt konsultativ në kuadër të punës për hartimin e draft planit të veprimit lidhur me komponentin nr. 3, “ Aksesi në drejtësi” të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur 2020-2022 u zhvillua në datën 21.10.2020 online, nëpërmjet Platformës WebEX Cisco.

Fillimisht, Znj.Elona Hoxha falenderoi pjesëmarrësit për prezencën e tyre në të gjitha takimet e realizuara duke vlerësuar bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë me sugjerime/mendime/propozime/ide me qëllimin që procesi të jetë sa më gjithëpërfshirës, transparent për arritjen e përmirësimit të draftit të planit të veprimit.Në vazhdimësi, ftoi të pranishmit për tu bashkuar qëllimit të diskutimit të takimit të fundit.

Znj.Petrina Broka Përfaqësuese e Klinikës së Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, në kuadër të masës **1.1.3** ku theksohet forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe institucioneve publike/organizatave kombëtare e ndërkombëtare si dhe aktorëve të shoqërisë civile në kuadër të forcimit të aksesit në drejtësi shprehet se do te ishte më frytëdhënëse nëse bashkëpunimi i përmendur më sipër nuk do të ishte vetëm ndërmjet Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe me aktoret e përmendur nga ana tjetër. Sugjeron që të gjithë aktorët të përmendur t’u mundësohej një forcim i bashkëpunimit jo vetëm me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, por edhe mes tyre, në kuader të aksesit në drejtësi. Ky bashkëpunim do të mundësojë përmirësimin e ndihmës juridike falas nga të gjithë aktorët.Gjithashtu, Znj. Broka referuar masës **1.1.2** thekson se:

Një kontribut shumë të mirë në trajnimin e target grupeve do të jepte edhe Klinika e Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, UT, i cili zotëron kapacitetet e duhura njerëzore dhe infrastrukturore për realizimin e trajnimeve. Për këtë arsye shprehet se duhet përfshirë në institucionet që mund të japë kontribut në këtë drejtim. Zgjidhja më e mirë do të jetë dhënia e Klinikës së Ligjit përgjigjësi direkte dhe një lloj zhvillimi duke qënë se pranë saj ka ekspertë të nivelit të lartë të reformës në Drejtësi.

Më pas fjala kalon tek Znj.Xhulia Mulla e cila në kuadër të masës prioritare dhe në përputhshmëri të komenteve të bëra nga Znj.Broka vijon me prezantimin e propozimit të një mase të re konkretisht masa **1.1.4** Krijimi i Forumit Ndërinstitucional për ndihmën juridike të garantuar nga shteti me sekretariat teknik në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas. Sa me sipër, Znj.Mulla thekson se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve që ofrojnë akses në drejtësi të mos jetë vetëm nëpërmjet institucioneve të Ministrisë e Drejtësisë dhe Drejtorisë e Ndhmës Juridike por dhe në kuadër të OJF njëra me tjetrën. Znj. Mulla përmendi se Klinikat dhe OJF trajtohen njësoj në aspektin e ofrimit të shërbimeve parësore, por sensi i masës dhe roli i Drejtorisë Juridike Falas do të humbasë në rast se termi trajnues do të jetë aq gjithëpërfshirës.

Erjon Capani iu bashkua diskutimit duke shprehur pëlqimin në lidhje me komentën e Znj.Broka dhe propozimin e bërë nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas duke ripërmendur që jep mbështetjen për të gjitha diskutimet dhe propozimet e realizuara në takimet e mëparshme.

Në përfundim të takimit, Znj Hoxha shprehu mirënjohje për prezencën e pjesëmarrësve duke filluar nga faza konsultative deri në përfundimin e procesit për propozimet e vyera që janë adresuar. Kerkoi nga ana e grupeve të interesit që çdo sugjerim/ndërrhyrje shtesë mund të dërgohet në adresat përkatëse të email.